

“Alias Power” SHPK,
NUIS L72316024T,
Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri
Kapitali i regjistruar: 100,00 Lekë.

KONTRATË PËR TRANSFERIMIN E KUOTAVE

Sot, më datë 11.01.2018, në orën 10:00, në adresën: Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri, hartohet dhe nënshkruhet ky akt ndërmjet personave në vijim:

- **Z. Glon BAKALLI**, shtetas shqiptar, i biri i Naxhi dhe Violeta, lindur më 10.08.1977, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 027651778 dhe me numër personal H70810052B, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar shkurt si **“Shitësi”**);

dhe

- **Z. Erlind KAPEDANI**, shtetas shqiptar, lindur më 12.01.1976, në Tiranë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit Nr. 024497942 dhe me numër personal H60112160D, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, administrator i shoqërisë shqiptare **“Anchor Investments” Sh.P.K.**, e themeluar më 04.01.2017 dhe regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar më 21.02.2017 me NUIS L71421016I dhe me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 1, Rr. “Themistokli Gërmenji”, Ambasador 1, Tiranë, Shqipëri, autorizuar përmes Vendimit datë 14.11.2017 të Asamblesë së kësaj të fundit (në vijim referuar shkurt si **“Blerësi”**).

Më poshtë Shitësi dhe Blerësi, bashkërisht do të referohen si **“Palët”** dhe individualisht secili prej tyre dhe si **“Pala”**.

MEQENËSE:

- A. Shitësi dhe Blerësi janë ortakë të shoqërisë **“Alias Power” SHPK**, shoqëri e së drejtës shqiptare, e themeluar më 15.11.2017 dhe e regjistruar pranë Regjistrimit Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit më 16.11.2017 me NUIS L72316024T, me seli në adresën: Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri dhe me administrator, Z. Glon BAKALLI (më poshtë referuar shkurt si **“Shoqëria”**);
- B. Shitësi zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara prej tij në shumën prej ALL 75.00 (shtatëdhjetë e pesë lekë shqiptare), e cila përfaqëson 75% (shtatëdhjetë e pesë për qind) të kapitalit të Shoqërisë me të drejtë vote dhe dëshiron t’ia shesë Blerësit një pjesë të kësaj kuote të barabartë me 8.3 % (tetë pikë tre për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë Blerësit, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate;



“Alias Power” SHPK,
NUIS L72316024T,
Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri
Kapitali i regjistruar: 100,00 Lekë.

C. Blerësi zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë me vlerë të barabartë me kontributet e nënshkruara prej tij në shumën prej ALL 25.00 (njëzet e pesë lekë shqiptare), e cila përfaqëson 25% (njëzet e pesë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë me të drejtë vote dhe dëshiron e pranon të blejë pjesën e kuotës që Shitësi synon të shesë, në përputhje me kushtet dhe afatet e kësaj Kontrate.

DUKE KONSIDERUAR SA MË SIPËR, Shitësi dhe Blerësi bien dakord që të lidhin këtë kontratë (referuar në vijim si “**Kontrata**”) si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

1.1 Shitësi do të transferojë dhe kalojë tek Blerësi, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë, një pjesë të kuotës që zotëron në kapitalin e regjistruar të Shoqërisë, pjesë e cila përfaqëson 8.3 % (tetë pikë tre për qind) të totalit të kuotave dhe kapitalit të regjistruar të kësaj Shoqërie (më poshtë referuar si “**Kuota e ofruar**”) dhe Blerësi do të marrë e blejë këtë Kuotë të ofruar nga Shitësi sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Kontratë kundrejt pagesës së çmimit të parashikuar në Nenin 2 më poshtë.

Neni 2

Çmimi i Transferimit të Kuotës

2.1 Palët bien dakord se çmimi për transferimin e Kuotës së ofruar për efekt të kalimit të së drejtës së pronësisë mbi këtë kuotë të ofruar dhe zbatimit të kësaj Kontrate do të jetë vlera nominale e Kuotës së ofruar prej ALL 8.30 (tetë lekë shqiptare e tridhjetë qindarka) dhe Palët pranojnë e bien dakord se çmimi paguhet nga Blerësi tek Shitësi sipas legjislacionit shqiptar në fuqi në momentin e lidhjes së kësaj Kontrate dhe Palët nuk kanë asnjë pretendim të tashëm, ose të ardhshëm në lidhje me pagimin e çmimit sipas kësaj Kontrate.

Neni 3

Kalimi i pronësisë dhe mbyllja e transaksionit

3.1 Kalimi i titullit të pronësisë së Kuotës së ofruar objekt i kësaj Kontrate nga Shitësi tek Blerësi do të realizohet në momentin e nënshkrimit të kësaj Kontrate nga të dyja Palët dhe në përfundim të transaksionit të përshkruar dhe rregulluar nga kjo Kontratë, Blerësi bëhet zotëruar me të drejta të plota i një Kuote që përfaqëson 33.3% (tridhjetë e tre pikë tre për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, pasi 25 % i zotëronte përpara nënshkrimit të kësaj Kontrate dhe 8.3% i përfiton si rrjedhojë e lidhjes së kësaj Kontrate.

“Alias Power” SHPK,
NUIS L72316024T,
Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri
Kapitali i regjistruar: 100,00 Lekë.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci të Palëve

4.1 Shitësi nëpërmjet kësaj Kontrate ri-siguron, deklaron dhe garanton Blerësin se:

- a) Shoqëria është person juridik i regjistruar rregullisht pranë Regjistrimit Tregtar të Republikës së Shqipërisë dhe se ushtron aktivitetin tregtar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe sipas dispozitave të Statutit dhe nuk është në proces falimenti, ose likuidimi dhe se janë paguar të gjitha detyrimet fiskale në përputhje me ligjin në fuqi dhe parimet e kontabilitetit;
- b) Kuota objekt e kësaj Kontrate është e lirë nga çdo peng, barrë siguroese, hipotekë, pengesë, pretendime të tretëve, kufizime, të drejta parablerje si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore e çfarëdolloj; dhe
- c) nuk ekziston asnjë marrëveshje, kontratë apo çdo lloj akti tjetër lidhur me ndonjë “ortak të fshehtë” dhe/ose lidhur me ndonjë detyrim, përgjegjësi, privilegj apo të drejtë tjetër që ngarkon mbi, apo mund të ngarkojë Kuotën e ofruar në ushtrimin e zotërimit të së drejtës së pronësisë mbi të, si dhe se nuk ekziston asnjë marrëveshje, kontratë, apo çdo lloj akti tjetër i ngjashëm, për sa i përket ndarjes së fitimit nga zotërimi i Kuotës së ofruar objekt të kësaj Kontrate dhe se Shitësi e ushtron të drejtën mbi Kuotën e ofruar vetëm për llogari dhe nën emrin e tij.

4.2 Blerësi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Shitësin se:

- a) Blerësi zotëron të gjitha të drejtat ligjore për nënshkrimin e kësaj Kontrate dhe se këto të drejta nuk janë objekt, apo në kundërshtim, apo nuk përbëjnë shkelje të ndonjë gjykimi, urdhri, vendimi gjyqësor, dekreti ose vendimi të çdo gjykate apo autoriteti tjetër, subjekt i të cilit është Blerësi, si dhe ndonjë marrëveshjeje, licence ose angazhimi në të cilin Blerësi është palë dhe që do të cenonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë.

Neni 5

Tërësia e Kontratës dhe ndryshimi i saj

5.1 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Kontrate është ose bëhet e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme, pavlefshmëria, pasaktësia apo pazbatueshmëria e kësaj dispozite nuk do të cenojë, apo shfuqizojë dispozitat e tjera të kësaj Kontrate. Çdo dispozitë e pavlefshme, e pasaktë apo e pazbatueshme do të zëvendësohet dhe/ose interpretohet me/sipas një dispozite tjetër të vlefshme, efektive dhe të zbatueshme që pasqyron efektet ligjore dhe qëllimin e parashikimit të dispozitës së shfuqizuar dhe synimet që i shtynë Palët të lidhin këtë Kontratë. I njëjti rregull aplikohet për gabimet apo mungesat e paqëllimshme.

5.2 Kjo Kontratë përbën marrëveshjen e plotë midis Palëve lidhur me parashikimet në të. Titujt apo emërtimet e shprehura në këtë Kontratë janë përfshirë vetëm për lehtësi referimi

“Alias Power” SHPK,
NUIS L72316024T,
Rruga “Pjetër Bogdani”, Nr. 37, Kati 2, Tiranë, Shqipëri
Kapitali i regjistruar: 100,00 Lekë.

në tekst dhe në këtë Kontratë në tërësi dhe nuk ndikojnë në interpretimin e kushteve dhe dispozitave të kësaj Kontrate.

5.3 Çdo parashikim i kësaj Kontrate mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të nënshkruar nga Palët e kësaj Kontrate dhe ndryshimet e kryera verbalisht nuk janë të vlefshme.

Neni 6

Juridiksioni dhe mosmarrëveshjet

6.1 Kjo Kontratë bazohet në dhe zbatohet sipas ligjit shqiptar në fuqi dhe interpretimi, vlefshmëria e përmbushja e saj realizohet dhe zbatohet në përputhje me ligjin shqiptar në fuqi. Çdo detyrim, apo kusht lidhur me zbatimin e kësaj Kontrate dhe që nuk parashikohet shprehimisht në këtë Kontratë do të rregullohet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në tërësi dhe me Kodin Civil dhe dispozitat e tjera ligjore të aplikueshme.

6.2 Çdo mosmarrëveshje apo kundërshtim që mund të lindë si rrjedhojë e, apo lidhur me interpretimin, ose zbatimin e kësaj Kontrate e që nuk mund të zgjidhet në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve, do t'i parashtrohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Shqipëri.

Neni 7

Gjuha e kontratës

7.1 Kjo Kontratë hartohet në 4 (katër) ekzemplarë në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë secila. Nga një ekzemplar i jepet secilës Palë, një ekzemplar ruhet pranë selisë së Shoqërisë dhe një ekzemplar depozitohet pranë Regjistratit Tregtar të administruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit.

SHITËSI

Z. Glon BAKALLI



BLERËSI

“Anchor Investments” Sh.P.K.
Përfaqësuar nga Z. Erlind KAPEDANI
(administrator)

